



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 7441 Prot.

Tiranë, më: 10.11.2020

URDHËR

Nr. 280, Datë 10.11.2020

“PËR

MIRATIMIN E PROJEKTEVE TURISTIKE QË PËRFITOJNË MBËSHTETJE
FINANCIARE NGA BUXHETI I SHETIT”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015, datë 27.07.2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, të pikës 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.04.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në turizëm”, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve,

URDHËROJ:

1. Miratimin e projekteve turistike, të kualifikuara nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, si më poshtë vijon:

- “ALBANIA, THE BEAUTIFUL, Territore dhe Njerez”
- “Shqiptarët e mrekullueshëm II”
- “Promovimi i zonave të mbrojtura”
- “Reklamimi i kalave dhe njohja e audiencës me historinë e tyre”
- “Kultura, Mjeshtëria dhe Turizmi një Partneritet Vital”
- dh. “Evidentimi dhe promovimi i shtigjeve të hiking në Shqipëri”
- “Tirana 100”
- “Krijimi i një databaze për hotelerinë në Shqipëri”
- “Modele për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit detar; Planifikimi dhe projektimi i aktiviteteve në zonat bregdetare”

2. Ngarkohet Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm, për publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të listës së projekteve përfituese të financimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

BLENDI KLOSI